

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 14 dhe nenin 29 paragrafi (2) nga Ligji për Media ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 63/24, 74/24 dhe 218/24), Udhëzimi për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacion në dispozicion të përdoruesve, ark.nr.01-4443/1 datë 09.10.2018, pika 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-4885/1 datë 21.11.2024 dhe Konkluzionin nr.02-5193/14 datë 26.12.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 46-të mbajtur më 25.12.2024 miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrje të masës - paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë, për shkeljen e kryer të nenit 14 të Ligjit për Media (LM), të mënyrës që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor televiziv më 4 nëntor 2024, nuk publikoi të dhënat për impresium të filmit të animuar "Tomi dhe Xheri (Tom dhe Jerry)", në regjistrimin e takimit përkujtimor të mbajtur për nder të profesoreshës së ndjerë Flamure Ibrahim-Sadiku, në intervistat me Azizi Memetin, pacient me paralizë cerebrale dhe me prof.dr.Halim Hida, pedagog dhe diplomat.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-4885/1 datë 21.11.2024, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e LM.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe nenit 29 të Ligjit për Media (LM), është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të mediave nga aspekti i pajtueshmërisë së punës të tyre me detyrimet e përcaktuara me nenet 6, 8, 14 dhe 15 të LM.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesit të medias (radio transmetuesit) ndërmerr masë - vërejtje publike në rastet kur ka cënim ose shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushtet dhe detyrimet e përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 29 paragrafi (2) të LM, masat që Agjencia si organ rregullator kompetente mund t'i ndërmarrë, të cilat janë të përcaktuara në LSHMAAV, zbatohen gjithashtu dhe në rast të shkeljes së dispozitave të LM.

Sipas nenit 14 të LM, botuesi i medias është i detyruar në vend të dukshëm për çdo bartës individual të përmbajtjes (për shembull, mostër e medias së shkruar dhe emisioni televiziv) të siguron publikimin e të dhënave të mëposhtme: emër dhe adresë të selisë dhe redaksisë së botuesit të medias, emri i personit përgjegjës të botuesit të medias, emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës, respektivisht redaktorët në përputhje me organizimin e brendshëm të redaksisë dhe emrin dhe adresën e shtypshkronjës dhe data e shtypjes ose ribotimit, si dhe numrin e kopjeve të shtypura, kur kemi të bëjmë me median e shkruar. Për transmetuesit, detyrimi i lartpërmendur zbatohet në atë mënyrë që të dhënat të publikohen në fillim ose në fund të programeve audio/audiovizive. Botuesi i medias është i detyruar në vend të përshtatshëm për çdo përmbajtje të publikojë këto të dhëna: emrin dhe mbiemrin e autorit të fragmentit të publikuar, emrin dhe mbiemrin e personit, respektivisht të shoqërisë që ka të drejtën e autorit për përmbajtjet e publikuara, përveç atyre të shtypura dhe programeve në radio, data e produksionit (muaji dhe viti) në rastin e një veprë audio/audiovizuale, origjina e veprës audio/audiovizuale dhe nëse vepra është krijuar nga producent i pavarur dhe informacioni për të, emrin e personit juridik, respektivisht emrin dhe mbiemrin e personit që ruan të mirën e përdorur kulturore ose veprën arkivore, pra riprodhimin përkatës dhe emrin e botuesit të medias nga i cili është marrë bashkëngjitja e programit ose klipi nga bashkëngjitja e programit, përveç rasteve kur me marrëveshje të ndërsjellë është rregulluar ndryshe.

Në pajtim me Udhëzimin për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacion në dispozicion të përdoruesve, ark.nr.01-4443/1 datë 09.10.2018, tek programet e tjera të prodhimit vendor, impresium publikohet në mënyrë që: në shpicën hyrëse ose dalëse publikohen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës të shërbimit programor; emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës të redaksisë nga e ka origjinën programi (nëse ka); emri dhe mbiemri i redaktorit/autorit/prezantuesit të emisionit; emri dhe mbiemri i bashkautorëve, respektivisht i gjithë ekipit televiziv me pjesëmarrje në tërësinë e veprës audiovizive; emrin e subjektit që ka prodhuar programin (vetë transmetuesi, bashkëproducentët, producenti i pavarur të cilit i është porositur programi) dhe data e produksionit (muajin dhe vitin). Nëse është e aplikueshme, duhet të publikohen të dhënat edhe për: emrin e personit juridik, respektivisht emrin dhe mbiemrin e personit që ruan të mirën kulturore ose veprën arkivore, respektivisht reproduksionin e veprës dhe emrin e subjekti tjetër nga i cili është marrë pjesë e caktuar ose bashkëngjitja, përveç rasteve kur me marrëveshje të përbashkët nuk është rregulluar ndryshe.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për Çështje Programore, më 21 nëntor 2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë, transmetuar më 4 nëntor 2024 ku ka konstatuar shkelje të nenit 14 të LM. Gjegjesisht, me mbikëqyrje u konstatua se në kundërshtim me LM dhe Udhëzimin për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacion në dispozicion të përdoruesve, pa impresium janë transmetuar: filmi i animuar "Tomi dhe Xheri (Tom dhe Jerry)", regjistrim nga takimi i mbajtur përkujtimor për nder të profesoreshës së ndjerë Flamure Ibrahim-Sadiku, intervistës me Azizi Memeti, pacient me paralizë cerebrale dhe intervistës me prof.dr. Halimi Hida, pedagog dhe diplomat. Në vendin e duhur, për çdo përmbajtje të shërbimit programor, transmetuesi është i detyruar të transmetojë të dhënat që identifikojnë autorët që kanë marrë pjesë në përgatitjen e përmbajtjes: - *emrin dhe mbiemrin e redaktorit përgjegjës të shërbimit programor*; - *emrin dhe mbiemrin e redaktorit përgjegjës të redaksisë nga ku buron origjina e programit*; - *emrin dhe mbiemrin e redaktorit / autorit / drejtuesit të emisionit*; - *emri dhe mbiemri i bashkautorëve, pra i gjithë grupit televiziv me pjesëmarrje në tërësinë e veprës audiovizive*; - *emrin e subjektit që ka prodhuar programin*; - *data e produksionit*. Shkelja nga pika 1 e këtij aktvendimi, caktohet sipas datës, titullit të emisionit, periudhës së transmetimit (fillimit dhe përfundimit) dhe përshkrimit në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-48885/1 datë 21.11.2024, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë, më 25.11.2024, dërgoi Shkresë nr.y në ark.10-4885/2 datë 25.11.2024, me të cilin ka dorëzuar Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-48885/1 datë 21.11.2024, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të paraqesë deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 27.11.2024. Këshilli i Agjencisë, në seancën e 46-të mbajtur më 25.12.2024, shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konstatoi që SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë t'i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjrdhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 14 dhe nenin 29 paragrafin (2) të LM, Udhëzimet për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacion në dispozicion të përdoruesve, pika 7 dhe 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për marrjen e masave (Tekst i pastruar), Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-48885/1 datë 21.11.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-5193/14 datë 26.12.2024, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LM, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 46-të mbajtur më 25.12.2024, miratoi Aktvendim ku publikisht paralajmërohet SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë, dhe urdhërohet që në afat prej prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LM. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-48885 datë 21.11.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.